


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	1V	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	+0.65%	+0.53%	+4.75%	+13.31%	+29.94%	+43.39%
BENÇMARKU*	+0.10%	+0.10%	+1.70%	+0.96%	+2.57%	+33.19%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET

ÇMIMI I AKSIONIT:

KORRIK	▼ -0.04%
GUSHT	▼ -0.08%
SHTATOR	▲ +0.65%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▲ +0.53%

KTHIMI BRUTO:

KORRIK	-€0.04 mln
GUSHT	-€0.58 mln
SHTATOR	+€10.75 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	+€10.16 mln

KRYESORET

ÇMIMI I AKSIONIT NË FUND TREMUJORI €1.4339	MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,574,777,471
MJETE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR €6.67 mln	MJETE TË SHPAGUARA KËTË VIT €21.53 mln
TË PENSIONUAR PËR PERIUDHËN 1,273	TË PENSIONUAR PËR VITIN 4,107
LLOGARI TË KONTRIBUESVE 575,280	LLOGARI AKTIVE NË FUND TË PERIUDHËS 325,049
KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT 33,434	KONTRIBUTE TË ARKËTUARA KËTË VIT €117.57 mln
SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT 85,111	GJITHSEJ LLOGARI NË TRUSTI 76,096

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES / EMETUES NË KËTË TREMUJOR

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS	PLASMANET	PJESËMARRJA	PERFORMANCA	KONTRIBUIMI NË PERFORMANCËN BRUTO TË FKPK
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€317,493,588	20.49%	+3.57%	+0.73%
Nordea	1-Stable Return Fund	€240,114,995	15.50%	-0.48%	-0.07%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€168,975,780	10.91%	-2.24%	-0.24%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€140,799,992	9.09%	-0.93%	-0.08%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€99,313,736	6.41%	+0.01%	+0.00%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€65,265,437	4.21%	+2.71%	+0.11%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€57,872,743	3.73%	-1.53%	-0.06%
Schroders	ISF Global Diversified Growth	€75,372,497	4.86%	+1.36%	+0.07%
Amundi	Rendement Plus Part I2	€51,773,843	3.34%	+1.25%	+0.04%
Amundi 3M	Amundi 3M - I	€80,418,146	5.19%	-0.04%	0.00%
BNP Parvest	Diversified Dynamic	€75,220,032	4.85%	+2.78%	+0.14%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€10,382,466	0.67%	-0.08%	-0.00%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione	€57,810,485	3.73%	+0.59%*	+0.02%
Thesari i Republikës së Kosovës	Fletobligacione	€18,256,266	1.18%	+0.07%*	+0.00%
BKT, BPB, TEB	Depozita me afat	€42,606,345	2.75%	+0.35%*	+0.01%
BQK - para të gatshme	Të painvestuara	€47,827,203	3.09%	-0.09%	-0.00%
GJITHSEJ		€1,549,503,554	100.00%	+0.66%	+0.66%

*Performanca e bazuar në norma fikse të interesit.

€10.16 MLN KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës e përfundoi edhe tremujorin e tretë 2017 me kthim pozitiv nga investimet prej €10.16 mln ose me një rritje prej 0.53% të çmimit të njësisë. Bashkë me kthimin nga tremujorët paraprak, nëntëmujori i këtij viti përfundon kështu me një kthim bruto prej €66.41 mln. Në TM3 mjetet nën menaxhim u rritën për €41.04 mln dhe arritën në €1,575.47 mln. Në rritjen e mjeteve nën menaxhim ndikuan: kthimi nga investimet (€10.16 mln) dhe kontributet e reja (€40.56 mln). Ndërkohë për të njëjtën periudhë: për pension u shpagueu €6.69 mln, për tarifa menaxhuese €1.88 mln dhe u refonduan €474.

FAKTORËT ME NDIKIM

Situata e favorshme e zhvillimit ekonomik në qendrat kryesore ekonomike (SHBA, Europë e Azi) ndikoi që ky tremujor të sjell fitime solide për tregun global të aksioneve. Treguesit makroekonomikë dhe zhvlerësimi i lehtë i dollarit ishin nxitës për ngritjen e indekseve kryesore në SHBA. Ndërkohë vazhdimi i trendit pozitiv ekonomik në Europë ka vënë në fokus të tregjeve mundësinë e reduktimit të masave stimuluese financiare. Njëkohësisht, ekonomia japoneze vazhdoi edhe këtë tremujor përmirësimin e treguesve ekonomikë, duke stimuluar rritjen e vlerës së aksioneve japoneze. Për këtë periudhë tejkaluan parashikimet e përmirësimit ekonomik edhe vendet në zhvillim, sidomos Brazili. Në anën tjetër, tregu i bonove nuk kishte ndonjë lëvizje të madhe, me bonot e korporatave që tejkaluan me kthim pozitiv bonot e qeverive.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Gjendja e përgjithshme e tregut global të kapitalit nuk u reflektua këtë tremujor në performancën e fondeve investuese të FKPK-së. Nga 12 fonde investuese të angazhuara performanca e tyre ishte ndarë përgjysmë: në 6 pozitive dhe 6 negative. Po ashtu performanca e tyre nuk rezultoi të jetë e varur nga dominimi në portofol i aksioneve ose bonove, por nga përzgjedhja e alokimeve individuale në portofolet përkatëse.

Me performancën më të mirë edhe këtë tremujor ishte fondi i pastër në aksione i Vanguard GSEF (+3.57%). Njëkohësisht, për shkak edhe të mjeteve nën menaxhim, ky fond kishte edhe kontribuim dukshëm më të lartë në performancën e FKPK-së sesa 11 fondet e tjera. Pas Vanguard GSEF renditeshin katër fondet në multiasete: BNP Parverst (+2.78%), AXA WF (+2.71%), Schoders GDG (+1.36%) dhe Amundi Rendement Plus (+1.25%). Ndërsa fondi i bonove globale të inflacionit i AXA GILB ia doli të ishte në terrenin pozitiv me +0.01%.

Në anën tjetër, nga fondet me performancë negative printe fondi në aksione i Nordea GSEF (-2.24%), i ndjekur nga fondi në aksione me ofrim dividendi i Pictet HDS (-1.53%), nga fondi i balancuar në aksione i BNY Mellon GRR (-0.93%) dhe nga fondi në multiasete i Nordea SRF (-0.48%). Dy fondet që ngelën për pak në terren negativ ishin fondi i bonove i Schoders SB (-0.08%) dhe fondi i tregut të parasë i Amundi 3M (-0.04%).

Nga ana tjetër, investimet në Kosovë (në obligacione dhe fletobligacione të Qeverisë dhe në depozita bankare) ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe kontribuan mesatarisht me 4.97% në performancën e përgjithshme të FKPK-së për këtë periudhë.

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE

+0.53%

KRYESORET E TREMUJORIT

BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E TRETË PËR 2017

Bordi Drejtues në mbledhjen e mbajtur në shtator 2017, pasi ka shqyrtuar gjendjen e të gjitha investimeve dhe fondeve investuese, dhe bazuar në strategjinë e investimeve mori vendime të tërhiqen mjetet si në vijim: €27 mln nga Pictet, €27 mln nga Nordea GSE, €72 mln nga Amundi 3M, €33 mln nga BNY Mellon. Bordi po ashtu vendosi që këto mjete të tërhequra të shërbejnë për financimin e investimeve në vijim: €34 mln në Schroders GDG; €50.5 mln në BNP Parvest; €44 mln në AXA-OI; €27 mln në Vanguard, dhe €33.5 mln në Amundi Rendement Plus. Vendim tjetër i rëndësishëm ishte edhe ndryshimi i kufijve dhe caqeve të matricës së alokimit strategjik, në harmoni me lëvizjet e mësipërme.

AMUNDI 3-M (I) I SHTOHET FONDEVE INVESTUESE

FKPK-ja ka investuar më 18 korrik 2017 në fondin e Amundi 3 M-I. Ky fond është themeluar më 1999 dhe ka nën menaxhim rreth €13.3 mld. Fondi bën investime në tregun e parasë së gatshme me synim ofrimin e sigurisë më të lartë investuese dhe nivelin më të ulët të oscilimeve. Ky investim ofron nivel të lartë të likuiditetit dhe ka për qëllim mbrojtjen dhe diversifikimin e investimeve të FKPK-së në rast të rënies së shpejtë dhe të fortë të tregjeve financiare.

TËRHEQJA E KURSIMEVE NGA SHTETASIT E HUAJ

Të gjithë shtetasit e huaj, me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, mund të aplikojnë për tërheqje të kursimeve pensionale, të cilat i kanë paguar përgjatë kohës sa kanë punuar në Kosovë. Sidoqoftë, nëse shtetasit e huaj, në momentin kur aplikojnë për një tërheqje të tillë, kanë fituar shtetësinë ose qëndrimin e përhershëm në Kosovë, nuk do të mund t'i tërheqin kursimet e tyre. Në rastin e aplikimit për tërheqje duhet të ofrohen një numër dokumentesh dhe dëshmish, dhe detajet për to mund të gjenden në linkun në vijim: <http://www.trusti.org/sq/dokumente-te-nevojshme/> tek pjesa e tërheqjes së kursimeve nga shtetasit e huaj.

RRITET NUMRI I KONTRIBUESVE TË RINJ

Numri i llogarive të reja në TM3 u rrit fort me 38,256 kontribuues (nga TM2: 286, 793). Kjo rritje e numrit të llogarive këtë tremujor lidhet me angazhimin e stafit për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme. Për këtë periudhë kontributet e reja u shtuan për €40.67 mln, duke qenë për €7mln më shumë se për të njëjten periudhë të një viti më parë.

€6.69 MLN PENSIONE TË TËRHEQURA NË TM3

Vlera e pensioneve të shpaguara këtë tremujor arriti në total €6.69 mln, ndërkohë që numri i llogarive të reja nga të cilat u tërhoqën mjetet numëruan 1,273. Pra, krahasuar me TM2 (1,514 të pensionuar dhe €8.18 mln shuma), këtë tremujor kishte rënie si në numër të përfituesve ashtu edhe në vlerë të tërheqjeve. Në tërësi për këta 9 muaj janë shpërndarë €21.53 mln ndërsa janë pensionuar rishtazi 4,107 llogari.

MBI 76 MIJË LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të TM3 2017 arriti në 76,096 ose një rritje prej rreth 4% për këtë tremujor. Inkurajues për 9 muajt e 2017 është treguesi i rritjes me 23% i përdoruesve të eTrusti (nga 61,635 sa ishte në fund të 2016). Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim: <https://online.trusti.org/>

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Tetor 2017

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. #182-184
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025
Zyra Qendrore: +381-38-600-020

info@trusti.org

www.trusti.org